

Mendim i ndarë

Në rastin penal PAKR 1/2017 kundër E.S.:

Me gjithë respektin unë nuk pajtohem me vendimin e shumicës së kolegjit për të urdhëruar rigjykimin e rastit në fjalë. Unë besoj që Gjykata e apelit duhet të vendosë siç duhet për të kundërshtimet e paraqitura nga palët në propozimet e tyre përkatëse të apelit dhe të vlerësojë të gjitha provat që do të konsideroheshin si të pranueshme. Gjithashtu, Gjykata e apelit duhet të kompletojë tërësinë e provave dhe të dëgjojë Rr.A. si dëshmitar në këtë rast.

Unë nuk pajtohem me mendimin e paraqitur në aktgjykim se *modus operandi* i kryerësit nuk ishte përcaktuar qartë nga Gjykata e shkallës së parë. Unë jam e bindur që rigjykimi sjell vonesë të panevojshme e cila është kundër interesit të drejtësisë.

Edhe pse dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk përputhet plotësisht me dispozitat përkatëse ligjore të Kodit të procedurës penale sepse i mungojnë elementet thelbësore *actus reus* arsyetimi i aktgjykimit paraqet gjetjet përkatëse të gjykatës. Arsyetimi në mënyrë eksplicite tregon se E.S. e përdori ndikimin e tij tek A.B. i cili iu bind urdhrin për të vlarë T.R. sepse ishte besnik dhe i bindej të pandehurit. Gjithashtu, gjykata gjeti se kishte një motivim përfitimi sepse familja e A. B. pranoi një shumë.

Unë mendoj se çdo vendim për anulimin e aktgjykimit dhe dërgimin e rastit në rigjykim merret vetëm në mënyrë të jashtëzakonshme, pra kur Gjykata e apelit nuk mund të veprojë në përputhje me nenin 403 të KPP-së dhe të ndryshojë aktgjykimi e ankimuar.

Në rastin në fjalë Gjykata e apelit nuk duhet të shmangë shqyrtimin gjyqësor të meritat e rastit do të thotë lidhur me veprimet që duhet t'i atribuohen të pandehurit.

Në veçanti, Gjykata e apelit ishte e obliguar:

1. të vendosë lidhur me pranueshmërinë e dëshmive të marra gjatë kontrollit të kryer në xxx e E.S. , duke marrë parasysh faktin se policia veproi pa një urdhër me shkrim të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe raporti siç kërkohet në pajtim me nenin 243 (7) të KPPK mungon;
2. të vendosë për pranueshmërinë e të ashtuquajtura "të dhëna triangulative" duke i konsideruar në mënyrë të duhur argumentimin e avokatit mbrojtës duke u bazuar gjithashtu në dispozitat e Ligjit për komunikim elektronik;

3. të vendosë nëse vendimi për dhënien e anonimitetit të dëshmitarit D është marrë në pajtim me nenin 224 të KPP-së.

Unë po ashtu besoj se Gjykata e apelit duhet *ex officio* të ftoj Rr.A. në cilësinë e dëshmitarit. Ai është i akuzuar si bashkë-kryes në vrasjen e T. R. dhe procedurat kundër tij janë në pritje.

Unë nuk shoh ndonjë arsye përse Gjykata e apelit duhet të shmangë vlerësimin e pranueshmërisë së dëshmive të përmendura më lart dhe të shmangë vlerësimin e tërësisë së provave që do të mbeteshin pranë. Kodi i procedurës penale të Kosovës lejon standardin e shqyrtimit të apelit dhe i jep gjykatësve të apelit instrumente të ndryshme për të mbledhur provat në mënyrë të kompletuar. Dërgimi i rastit në rigjykim sjell administrimit të drejtësisë një vonesë të panevojshme pasi është shumë e parashikueshme që çështjet e kundërshtuara do të paraqiten sërish për shqyrtimin e ankesës. Nuk ka rregulla procedurale që do të parandalonin Gjykatën e apelit për të ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar dhe të marrë vendimin për fajësinë apo pafajësinë dhe në rast të aktgjykimit fajësues - lidhur me dënimin. Në përgjithësi Kodi lejon të ashtuquajturën rishikim *de novo*. Gjykata e apelit duhet të veprojë sikur ta shqyrtonte rastin herë të parë, duke mos i dhënë asnjë nder vendimit të gjykatës së shkallës më të ulët. Procedura penale në Kosovë lejon që edhe i akuzuarin që është liruar nga gjykata e shkallës së parë të dënohet në shkallë të dytë. Në shembullin e rastit të fundit, i pandehuri i cili është shpallur fajtor vetëm nga ana e Gjykatës së apelit ka të drejtë të ankohet kundër tij në Gjykatën supreme. Në të vërtetë ky është argumenti më i mirë se procedura penale në Kosovë parashikon standardin *novo* të apelimit. Vendimet e një gjykatë të shkallës më të ulët për ligjin dhe dëshmitë duhet të shqyrtohet gjithmonë duke përdorur këtë standard.

Për këto arsye, me gjithë respektin, unë kam mendim të ndarë.

Anna Adamska – Gallant

Gjyqtare e EULEX-it